



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8.3.2023

Nr: 115

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “MINORITETI ETNIK GREK PËR TË ARDHMEN”, PËR
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË
DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë, 8.3.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1037 Prot., datë 22.2.2023, me:

Kërkues: Partia politike “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”, me kryetar z. Kristo Kiço.

Objekti: Regjistrimi i partisë politike “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

Baza ligjore: Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Partia “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Kristo Kiço, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023, administruar.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 02.02.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se partia “Minoriteti Etnik Grek për të

Data: 8.3. 2023 Nr: 115
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Minoriteti Etnik Grek Për të Ardhmen”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

Ardhmen”, me iniciale “MEGA”, me Kryetar z. Kristo Kiço, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;

- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike, (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”, me shkronja nistore “MEGA”, me adresë Lagjia nr. 1, “Rruga e Flamurit”, Sarandë;
- b) Kryetari i partisë është z. Kristo Kiço, me adresë Lagjia nr. 1 Rr “Alex Verli”, Sarandë;
- c) Financieri i partisë është zj. Krisanthi Naco, me adresë “Lagjia nr. ”, Sarandë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është zj. Katerina Thodhori, me adresë Finiq;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga partia “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga partia “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64 pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, nenin 64 pika 2 dhe nenin 92 /2 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të udhëzimit nr.1, datë 18.1.2023, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”

VENDOSA:

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”, me kryetar z. Kristo Kiço, me shkronjat nistore “MEGA”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023,
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI